
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Zyra e Personelit Kancelarija za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	02Nr.32/19	Data: 13.02.2019	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe me qëllim të realizimit të projektit "Pagesat Direkte (Subvencione) për fermer" i cili mbështetet financiarisht nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Istogut shpall:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve me Marrëveshje për Shërbime te veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Vendi i Punës: Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte (Subvencione)

Nr. i referencës: 02Nr.32/19

Lloji i Pozitës: Marrëveshje për Shërbime te Veçanta - kohëzgjatja 2 muaj,

Numri i Ekzekutuesve: 4 (katër)

Orari i plotë: 40 orë ne javë

Paga : 350 €

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi dhe verifikimi i aplikacioneve
- Digjitalizimi i parcelave
- Pranimi i kërkesave të ndryshme nga palët
- Pranimi i palëve
- Sistemimi dhe ruajtja e aplikacioneve
- Të mbajë shënime (data bazë) në EXCEL dhe kopje fizike
- Të ofroj fermerëve udhëzime të sakta për kompletimin e dokumentacionit
- Detyra shtesë të parapara sipas MBPZHR dhe mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :

Të drejtë konkurimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për te vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimit shkollor, Fakulteti i Bujqësisë
- Dy rekomandime
- Dokument identifikimi
- Certifikata e lindjes ose ekstrakti
- Përvoja e punës në programet Elpis dhe Efr
- Certifikata qe nuk jeni nën hetime

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit 13.02.2019 deri më 20.02.2019

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “

Kërkesat e dërguara pas datës se fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do te pranohen.

Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi

